

## GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË FLET PËR EKONOMINË SHQIPTARE

Intervistë në BIE - Balkan Information Exchange, në 28 shtator 2001.

**BIE\*\*:** *Cilët janë treguesit kryesorë ekonomikë për Shqipërinë tani që është zgjedhur qeveria e re ?*

**Përgjigje:** Qeveria e re do të fillojë punën e saj me një ekonomi që vazhdon të ecë drejt balancimeve makroekonomike tashmë të vendosura gjatë periudhave të mëpërparshme. Aktiviteti ekonomik në tetë muajt e parë të vitit, nga janari në gusht, tregoi zhvillim të vazhdueshëm, në përputhje me parashikimet për një rritje vjetore të PBB-së prej 7.3 për qind. Papunësia është në nivelet e saj më të ulëta në katër vjet. Në fund të gushtit, financimi i brendshëm i deficitit buxhetor ishte 15.4 miliardë lekë ose 2.54 për qind e PBB-së. Gjatë gjysmës së parë të vitit eksportet ishin 36 për qind më të larta se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa importet ishin rritur me 24 për qind duke rezultuar një ulje të lehtë në deficitin tregtar të jashtëm në krahasim me të njëjtën periudhë për vitin 2000. Në fund të gushtit inflacioni vjetor ishte 4.1 për qind.

**BIE:** *Treguesi për inflacionin duket të jetë rritur. A përbën ky një kërcënim për ekonominë shqiptare në afatin e shkurtër?*

**Përgjigje:** Banka e Shqipërisë ka shqyrtuar zhvillimet më të fundit si dhe ato të parashikuarat në mënyrë që të përcaktojë qëndrimin në lidhje me normat afatshkurtra të interesit pavarësisht faktit që inflacioni bazë dhe matësit e tjerë të tij sugjerojnë një normë reale interesi të stabilizuar në normat 0 deri 2 për qind. Në 15 gusht, banka rriti interesin e repove ( norma e riblerjes për fondet e marra përkohësisht hua nga bankat tregtare) nga 6.5 në 7 për qind. Ndryshimi nuk do të thotë detyrimisht që ekonomia shqiptare pret situata inflacioniste të rëndësishme ose probleme të tjera serioze. Megjithatë, ekonomia e një vendi, në rastin tonë Shqipëria, përballet me situata të paparashikuara që mund të veprojnë si faktorë "shock". Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë mendon që presionet inflacioniste janë rritur. Këtu përfshijmë krizën në Maqedoni, krizën financiare në Turqi dhe rënien ekonomike në BK dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Brenda vendit, çmimet e konsumit kanë qenë subjekt i presioneve inflacioniste nga oferta e kufizuar e

energjisë gjatë muajve të verës dhe e një rritjeje të investimeve publike në vend.

**BIE:** *Disa analistë të medias interpretuan komentet tuaja në gusht për inflacionin dhe shpenzimet qeveritare si një paralajmërim i një krize të mundshme. Cili është reagimi juaj?*

**Përgjigje:** Në 22 gusht unë mbajta një konferencë të zakonshme shtypi për të shpjeguar vendimin e politikës monetare, me fjalë të tjera vendimin e Bankës së Shqipërisë për të rritur normën e repove. Unë tërhoqa vëmendjen për praninë e presioneve inflacioniste të sipërpërmendura, por unë nuk paralajmërova një krizë ekonomike e cila nuk ekziston. Unë mendoj se megjithë disa keqinterpretime, komentet dhe reagimet e medias në Shqipëri kanë luajtur një rol pozitiv në bërjen e institucioneve publike vendase më të ndjeshme dhe më të vëmendshme në nevojën e luftës së ashpër kundrejt rrezikut të inflacionit.

**BIE:** *A janë objektivat e Bankës së Shqipërisë në përputhje me programin e ri të qeverisë?*

**Përgjigje:** Programi i qeverisë është ambicioz në objektivat e tij për të rritur investimet publike në infrastrukturë, në shëndet dhe në arsim. Banka e Shqipërisë mirëpret qëllime dhe objektiva të tilla, por në të njëjtën kohë është detyra e saj të sigurojë që nivelet e shpenzimeve dhe të deficitit buxhetor nuk janë tejkaluar për pjesën e mbetur të periudhës. Programi i qeverisë duket të jetë në përputhje me objektivat e Bankës së Shqipërisë. Mendoj që së shpejti ne do të kemi përputhje të plotë dhe të detajuar së shpejti me përfundimet e programit të *Rritjes Ekonomike dhe Reduktimit të Varfërisë* (program në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore) për vitet 2002- 2005.

**BIE:** *A e ka ndikuar kriza e Maqedonisë ekonominë shqiptare?*

**Përgjigje:** Në përgjithësi, rajoni po lëviz drejt integritit dhe bashkëpunimit. Ekonomitë tona po bëhen gjithnjë e më të ndërvarura. Kështu, krizat dhe problemet në rajon ndikojnë reciprokisht. Siç përmenda më lart, kriza në Maqedoni ka ndikuar ekonominë shqiptare. Çmimi i frutave dhe i perimeve të importuara është rritur lehtë sepse mjetet e zakonshme të transportit nga Maqedonia u ndërprehen.

*BIE:* Si i parashikoni marrëdhëniet ekonomike të ardhshme të Shqipërisë në rajon?

**Përgjigje:** Unë jam shumë pozitiv për sa i përket marrëdhënive ekonomike të ardhshme të Shqipërisë në rajon. Banka e Shqipërisë ka intensifikuar kontaktet e saj me bankat qendrore të tjera të vendeve të Ballkanit. Për shembull, Banka e Shqipërisë pas vizitës më të fundit në Bankën Qendrore të Turqisë po përgatitet të nënshkruajë një marrëveshje për shkëmbim të institucionalizuar të informacionit dhe përvojës. Të gjitha vendet e Ballkanit nënshkruan, më 27 korrik, në Bruksel një memorandum mirëkuptimi për liberalizimin dhe lehtësimin e tregtisë ndërmjet vendeve të Europës Juglindore. Shqipëria dhe Maqedonia kanë qenë në diskutime për vendosjen e një marrëveshjeje tregtie të lirë dypalëshe. Diskutime të tilla ka pasur me Qeveritë Kroate dhe Malazeze si dhe me Autoritetet Administruese në Kosovë. Mendoj se realizimi i një tregu të lirë në Ballkan nuk është i largët, kjo falë përpjekjeve të të gjitha vendeve të Ballkanit.